



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 24.7.2019

Lënda: Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit z. Gentjan Osmani, konfirmuar në detyrë me vendimin nr. 61, datë 2.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të trupit gjykues,

Në çështjen objekt shqyrtimi, nisur nga gjendja e akteve dhe vlera provuese e tyre, të cilat Komisioni i Pavarur i Kualifikimit i ka konsideruar të mjaftueshme që me vendimin nr. 61, datë 2.8.2018, të konfirmojë në detyrë subjektin e rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, Komisioneri Publik nuk ndan të njëjtin qëndrim. Në këto kushte, Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, vuri në lëvizje juridiksionin rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pasi arriti në përfundimin se vendimi i Komisionit është i cenueshëm sa i takon vlerësimit mbi mjaftueshmërinë e burimeve të krijimit të pasurive të paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, si dhe në drejtim të saktësisë dhe plotësisë së deklaramit të kryer nga subjekti i rivlerësimit mbi burimin e krijimit dhe të ardhurat e deklaruara si të përdorura për krijimin e tyre.

Kështu, Komisioneri Publik kërkoi nga ana e këtij Trupi të nderuar të vlerësojë për:

1. Pamjaftueshmëri në burimet e krijimit të pasurisë: apartament banimi me sip. 96 m², blerë në janar të vitit 2017, Tiranë

Komisioneri Publik, për sa i përket pasurisë **apartament banimi me sip. 96 m², blerë për shumën 82.000 euro, në janar të vitit 2017**, nga aktet e administruara në fashikull, ka konstatuar pamjaftueshmëri në burimet e krijimit të kësaj pasurie, pamjaftueshmëri të cilat i ka argumentuar në ankimin e tij të datës 15.11.2018.

Si burim krijimi për blerjen e apartamentit në shumën 82.000 euro, subjekti ka deklaruar llogari pranë *** Bank, e krijuar nga shitja e pasurisë apartament me sip. 72 m,² për vlerën 80.000 euro¹,

¹ Referuar kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2016.

si dhe derdhja e shumës prej 2.000 euro, pranë kësaj llogarie bankare, në datë ***.1.2017, me burim krijimi nga kursimet e subjektit dhe të bashkëshortes.

Subjekti i rivlerësimit si burim krijimi të apartamentit me sip.72 m², shitja e të cilit është “origjina” e pasurisë së deklaruar apartament me sip. 96 m², ka deklaruar: (i) të gjitha kursimet *cash* në vite së bashku me bashkëshorten; (ii) hua në shumën 20.000 euro dhe (iii) dhurimin nga prindërit e bashkëshortes/personat e tjerë të lidhur, në shumën 1.500.000 lekë.

Lidhur me kursimet cash, të deklaruara të akumuluar në vitin 2009. Referuar deklaramëve periodike të subjektit deri në këtë periudhë, në vlerësim të Komisionerit Publik, këto kursime mbulohen nga të ardhurat me burime financiare të ligjshme.

Lidhur me huan. Në vlerësim të Komisionerit Publik, edhe pas paraqitjes së provave të reja në seancën e datës 11.7.2019, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë dhe vërtetojë bindshëm mënyrën se si kjo hua ka mbërritur te subjekti i rivlerësimit² dhe si janë shlyer këstet e saj, sipas deklaramëve të tij në vitet 2011-2013.

Në përfundim, Komisioneri Publik ka vlerësuar se provat dhe aktet e paraqitura mbi këtë shkak ankimi nuk mund të konsiderohen si dokumentacion justifikues ligjor mbi burimin e ligjshëm të huas, duke provuar të kundërtën për sa ka rezultuar, sikundër ato nuk provojnë dhe vërtetojnë ekzistencën e kësaj marrëdhënie huaje.

1.1 Pamundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për të shlyer me të ardhura të ligjshme (i) këstet e apartamentit dhe (ii) këstet e huas

Komisioneri Publik, në vëmendje dhe të orientimit të dhënë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në prg. 39 të vendimit (JR) nr.7/2019, në shkaqet e ankimit, ka analizuar mbi mundësinë financiare të subjektit për të shlyer këstet e apartamentit dhe huas, bazuar në sa vetë subjekti ka deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë në deklaratat periodike vjetore.

Subjekti, në seancën e datës 11.7.2019, mbi diferencat e konstatuara për shpenzimet dhe kursimet e viteve 2005, 2009, 2011, 2012 dhe 2013, ka sqaruar *se gjatë këtyre viteve ka deklaruar në mënyrë të pasaktë e të paplotë ndryshimin e pasurive, duke paraqitur vit pas viti vetëm shtesat e pasurive dhe jo pakësimet e tyre, si dhe ka deklaruar kursimet në cash, duke pasur parasysh këtu edhe kursimet në llogaritë bankare.*

Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpjegimet e subjektit mbeten në nivel pretendimi të paprovuara dhe janë në kundërshtim me ligjin nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, të ndryshuar.

Komisioneri Publik, ashtu sikurse dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit, ka arsyetuar³, ndan mendimin se legjislacioni në fuqi që përcakton mënyrën, llojin, objektin dhe afatin e deklarimit të pasurisë dhe interesave private ka qenë më se i qartë në drejtim të përcaktimit të detyrimit për deklarim dhe mënyrës së deklarimit. Mënyra e deklarimit periodik ka mbetur e pandryshuar, pavarësisht ndryshimeve që mund të kenë pësuar ndër vite ligjet e zbatueshme, lidhur me deklarimin dhe

² Referuar dhe jurisprudencës së KPA-së në vendimin nr. 12, datë 17.12.2018; Vendimi nr. 6, datë 28.2.2019.

³ Referuar vendimit nr. 11/2019.

kontrollin e pasurive dhe konfliktin e interesave dhe, për rrjedhojë, subjekti nuk ka qenë asnjëherë në kushtet e paqartësisë ligjore në drejtim të detyrimit për deklarim dhe mënyrës së këtij deklarimi.

Në vijim, Komisioneri Publik konstaton se, edhe sikur të konsideronim huan si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit përsëri është në *pamundësi financiare për të shlyer me të ardhura të ligjshme: (i) këstet për shlyerjen e apartamentit dhe (ii) këstet e deklaruara për shlyerjen e huas.*

(i) Lidhur me momentin e pagesës së këstit të apartamentit në vitin 2009. Subjekti, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka ritheksuar se shlyerja e këstit të apartamentit nuk është bërë në mars të vitit 2009, sikundër reflektohet në mandat-arkëtimin e vënë në dispozicion nga shoqëria “****” sh.p.k., por deri në fund të vitit 2009.

Komisioneri Publik çmon se momenti i shlyerjes së pagesës është ai i reflektuar në mandatin e arkëtimin të paraqitur nga shoqëria “****” sh.p.k., në vlerësim të faktit se mandati i marsit 2009 ka vlerë të plotë provuese, pasi në të paraqitet situata reale faktike e veprimit juridik të pagesës së këstit. Marrë në konsideratë këtë fakt, mbetet i pandryshuar konkluzioni se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme këstet e paguara deri në 31.3.2009, në vlerën - **1.041.085** (një milion e dyzet e një mijë e tetëdhjetë e pesë) lekë.

Megjithatë, edhe sikur të pranohet shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbi pagesën e këstit të apartamentit, në fund të dhjetorit të vitit 2009, përsëri rezulton se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme pagesat e apartamentit dhe kursimet e krijuara deri në fund të vitit 2009, për një diferencë negative prej - **890, 349** (tetëqind e nëntëdhjetë mijë e treqind e dyzet e nëntë) lekë⁴. Sigurisht, në fund, vendimmarrja i takon këtij kolegji të nderuar.

(ii) Lidhur me shlyerjen e kësteve të huas. Komisioneri Publik, nga aktet e administruara në fashikull, ka konstatuar pamundësinë e mbulimit me burime të ligjshme të pagesave/shlyerjeve të huas dhe krijimin e kursimeve. Ashtu sikurse është argumentuar dhe më lart, analiza është bazuar në sa vetë subjekti ka deklaruar në deklaratën e interesave periodike vjetore.

Komisioneri Publik, edhe pas vlerësimit të provave të reja, si dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, mbi verifikimin dhe llogaritjen e të ardhurave nga pagat⁵, konstaton se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet për **vitin 2011**, në shumën 1,044,035 (një milion e dyzet e katër mijë e tridhjetë e pesë) lekë, dhe për **vitin 2013**, në shumën 1,145,915 (një milion e njëqind e dyzet e pesë mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) lekë⁶.

Në vijim të sa më sipër, për sa i takon shkakut të ankimit lidhur me mundësinë për të krijuar me burime të ligjshme pasurinë apartament banimi 96 m², arrijmë në përfundimin se vendimi i Komisionit është i cenueshëm sa i takon: **(1)** vlerësimit mbi mjaftueshmërinë e burimeve të krijimit të kësaj pasurie, **(2)** në drejtim të saktësisë, plotësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramit të kryer

⁴ Llogaritjet janë rishkuar, bazuar në pretendimet e subjektit mbi të ardhurat nga paga për subjektin dhe bashkëshorten, verifikuar sipas lëvizjeve të llogarive bankare. Për pagesat e kësteve gjatë vitit 2009, për konvertimin e shumave të pagesave në euro, janë marrë në konsideratë pretendimet e subjektit gjatë shpjegimeve të tij. Shpenzimet e jetesës janë llogaritur rishkuar sipas provës 3 të subjektit. Për sa i përket provave nr. 6 dhe 7 të paraqitura nga subjekti, në ankimin e Komisionerit Publik, shpenzimet e udhëtimit për vitin 2009 janë llogaritur sipas pretendimeve të subjektit në parashtratat e rezultateve të hetimit, pra shumat për të cilat subjekti ka paraqitur provat nr. 6 dhe 7, nuk janë ngarkuar në shpenzimet personale të subjektit të rivlerësimit.

⁵ Referuar lëvizjeve në llogaritë bankare, rishikimit të shpenzimeve të jetesës, sipas konfirmimit nga INSTAT-i.

⁶ Llogaritjet janë rishkuar bazuar në pretendimet e subjektit mbi të ardhurat nga paga për subjektin dhe bashkëshorten, verifikuar sipas lëvizjeve të llogarive bankare. Shpenzimet e jetesës janë llogaritur rishkuar sipas provës 3 të subjektit.

nga subjekti i rivlerësimit, mbi burimin e krijimit dhe të ardhurat e deklaruara si të përdorura për krijimin e tyre.

2. Mbi burimin e ligjshëm të krijimit të dhurimit të shumës 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë

Komisioneri Publik, për këtë shkak ankimi, është bazuar në sa ka rezultuar nga të dhënat e disponuara në dosjen e Komisionit, ku të ardhurat e babait të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit ishin marrë referuar lëvizjeve të llogarisë bankare të këtij të fundit pranë ***. Subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 11.7.2019, paraqiti prova të reja për të provuar të kundërtën e këtij shkakut ankimi.

Komisioneri Publik, referuar të dhënave të provave të reja të paraqitura, në konsideratë të të ardhurave të bashkëshortes së subjektit, për periudhën 2002-2008, si dhe duke llogaritur shpenzimet e jetesës sipas të dhënave të paraqitura në shkresën e INSTAT-it për të njëjtën periudhë, i rezultoi se personat e tjerë të lidhur mbulojnë me burime të ligjshme shumën e dhuruar prej 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh.

3. Mbi pasurinë: autoveturë tip “VW Golf”

Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaramet periodike për vitet 2003-2006. Saktësimi që subjekti i rivlerësimit i bën deklarameve të vitit 2009, mbi kursimet *cash*, nuk qëndron në linjë logjike me kërkesat e formularit të deklaramit të pasurive dhe me deklaramet ndër vite të vetë subjektit. Sa më sipër, konstatojmë se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklaram të saktë dhe të mjaftueshëm për vitin 2005. Vlen të theksohet që Komisioneri publik nuk ka pretendime për burimin e ligjshëm të kësaj pasurie dhe pasaktësitë e subjektit të rivlerësimit janë të vogla në raport gjithmonë me vlerën e kësaj autoveture.

KËRKIMI I ANKIMIT

Në këto kushte, referuar nenit F të aneksit të Kushtetutës, në konsideratë të shkaqeve të ngritura në ankim dhe sa kemi parashtruar gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje, përfundimisht, Komisioneri Publik, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3 të aneksit të Kushtetutës, nenin 33, pika 5, germa “b”, nenin 61, pika 3, dhe nenin 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit:

- Ndryshimin e vendimit nr. 61, datë 2.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA